

ZBATIMI I LIGJIT PËR TË HUAJT DHE LIGJIT PËR AUTOMJETET NË KOSOVË:

ËSHTJET KYÇE DHE IMPLIKIMET PRAKTIKE



NEW
SOCIAL
INITIATIVE

Publikuar nga:

Nisma e Re Sociale – NSI

www.newsocialinitiative.org

Autore:

Milica Radovanović

Mars 2026, Mitrovica e Veriut

“Ky projekt mbështet arritjen e Objektivave të mëposhtme të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG): Barazia Gjinore; Reduktimi i Pabarazive; Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta; Partneritetet për Objektivat.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në video janë vetëm të pjesëmarrësve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e United Nations, përfshirë United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK), apo të partnerëve zbatues të UNMIK-ut, NSI.”

HYRJE

Ky raport përmbledh gjetjet nga Dialogu Tematik i Forumit ‘Pulsi i Komunitetit’ mbi Ligjin për të Huajt dhe Ligjin për Automjetet, i përplotësuar me informacione të përgjithshme mbi kornizën ligjore përkatëse, komunikimin institucional dhe çështjet e paqarta të identifikuar më parë. Ndonëse diskutimi në forumin e ‘Pulsit të Komunitetit’ shërben si një burim i njohurive empirike, raporti gjithashtu i vendos këto perspektiva në një kontekst më të gjerë politik, ligjor dhe institucional që ndikon në zbatimin e këtyre dy ligjeve.

Së bashku, kjo qasje ofron si një pasqyrë të rrethanave në të cilat është zhvilluar diskutimi, si dhe një përshkrim të bazuar në evidencë mbi mënyrën se si këto dy ligje perceptohen dhe përjetohen në praktikë. Qëllimi i këtij dokumenti është i trefishtë:

- të përshkruajë në vija të përgjithshme kontekstin më të gjerë ligjor, politik dhe institucional në të cilin po zbatohen këto dy ligje;
- dtë sistematizojë problemet kyçe, rreziqet dhe paqartësitë e identifikuar përmes diskutimit në Forumin e ‘Pulsit të Komunitetit’, si dhe shqetësimet e tjera të dokumentuara mirë;
- t’i vendos këto gjetje brenda një konteksti më të gjerë kumulativ që ndikon në qartësinë juridike, stabilitetin shoqëror dhe besimin tek institucionet, veçanërisht në radhët e komuniteteve jo-shumicë.

Raporti përqendrohet në efektet praktike dhe pasojat e perceptuara të zbatimit të Ligjit për të Huajt dhe të Ligjit për Automjetet, dhe jo në çështjet që lidhen me ligjshmërinë ose kushtetutshmërinë e tyre formale. Ai bazohet në përvojat e jetuara dhe praktikët e vëzhguara për të vlerësuar se si këto ligje funksionojnë në praktikë nën kushtet aktuale institucionale dhe politike

HISTORIKU DHE KONTEKSTI

PSE KËTO LIGJE JANË TË RËNDËSISHME NË KËTË MOMENT

Megjithëse si Ligji për të Huajt ashtu edhe Ligji për Automjetet janë në fuqi prej disa vitesh, rëndësia e tyre praktike është rritur në dritën e komunikimit të fundit publik nga institucionet e Kosovës. Deklaratat zyrtare kanë bërë të ditur se zbatimi i plotë i Ligjit për të Huajt është parashikuar të nisë më 15 mars 2026, pas dy shtyrjeve të mëhershme - nga njoftimi fillestar për 1 tetor, në 15 janar dhe më pas në 15 mars.

Për shumë banorë, ky komunikim ka krijuar një ndjenjë të theksuar urgjence dhe ankthi. Shqetësimi nuk ka të bëjë krejtësisht me ekzistencën e vetë ligjeve – korniza të ngjashme rregullatore ekzistojnë në shumë vende – por me faktin se zbatimi i tyre po bëhet brenda një konteksti shumë specifik të marrëdhënieve të pazgjidhura politike dhe institucionale në Kosovë. Në kushte të tilla, zbatimi i këtyre ligjeve rrezikon t’i vë shumë individë në situata të pasigurisë juridike dhe vështirësive praktike, jo për shkak të rregullave si të tilla, por sepse konteksti më i gjerë në të cilin ato zbatohen mbetet i pazgjidhur.

Përtej përmbajtjes juridike të dy ligjeve, komunikimi publik i kohëve të fundit nga institucionet ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimeve mbi urgjencën dhe rrezikun. Njoftimet e përsëritura për afatet e zbatimit, të shoqëruara me theksim të sanksioneve, nuk janë shoqëruar me udhëzime po aq të qarta dhe të qasshme për procedurat, garancitë apo mjetet e disponueshme juridike. Si rezultat, pasiguria buron jo vetëm nga përmbajtja e ligjeve, por edhe nga mënyra se si zbatimi i tyre është paraqitur dhe komunikuar publikisht.

LIGJI PËR TË HUAJT

Sipas Ligjit për të huajt, një “i huaj” përkufizohet si çdo person që nuk ka shtetësinë e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, vendi i lindjes apo kohëzgjatja e banimit në vend. Në përgjithësi, shtetasit e huaj duhet të:

- të regjistrojnë adresën e banimit pranë autoriteteve kompetente brenda afateve të përcaktuara, duke përfshirë detyrimin për të njoftuar çdo ndryshim të adresës brenda një periudhe të përcaktuar ligjërisht;
- të respektojnë dallimin ndërmjet qëndrimit afatshkurtër dhe atij afatgjatë, ku qëndrimi afatshkurtër kufizohet në 90 ditë brenda një periudhe 180-ditore, përveç nëse kërkohet vizë ose leje qëndrimi;
- të aplikojnë për leje qëndrimi të përkohshëm kur qëndrojnë më shumë se 90 ditë ose kur banojnë për qëllime specifike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në punësim, arsim, kërkim shkencor, ribashkim familjar, arsye humanitare ose qëllime të tjera të njohura ligjërisht;
- të dëshmojnë qëllimin e qëndrimit përmes dokumentacionit të duhur (p.sh., dëshmi të punësimit, regjistrimit në një institucion arsimor të akredituar, lidhjes familjare ose marrëveshjes kontraktuese), siç kërkohet për kategorinë përkatëse të qëndrimit;
- të kenë dokumentacion të vlefshëm personal dhe të udhëtimit, përfshirë një dokument udhëtimi të vlefshëm, dhe, sipas rastit, një vizë ose leje qëndrimi, si dhe dëshmi të mjeteve të mjaftueshme të jetesës dhe të sigurimit shëndetësor;
- të përmbushin detyrimet për regjistrim, raportim dhe vazhdim (rinovim), përfshirë paraqitjen me kohë të kërkesave për rinovim ose vazhdim të lejeve të qëndrimit dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente gjatë procedurave administrative;

Mosrespektimi i këtyre detyrimeve mund të rezultojë në sanksione administrative, gjoba, refuzim ose revokim të lejeve të qëndrimit, ose vendime për kthim vullnetar ose të detyruar, duke iu nënshtruar procedurave ankimore të përcaktuara me ligj.

PROBLEMET KYÇE

Si në Ligjin për të Huajt ashtu edhe në Ligjin për Automjetet, barrierat lidhur me dokumentacionin shfaqen si një problem strukturor qendror dhe ndërsektorial. Vështirësitë në marrjen ose njohjen e dokumenteve personale – veçanërisht në lidhje me gjendjen civile, regjistrim të vendbanimit, punësim dhe arsimim – funksionojnë si pengesë sistematike që ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e personave për të përmbushur kërkesat ligjore.

Në vend se të veprojnë si pengesa të izoluara administrative, këto barrierat lidhur me dokumentacionin shkaktojnë efekte zinxhirë në disa fusha të ndryshme rregullatore, duke formësuar mënyrën se si ligjet përjetohen dhe zbatohen në praktikë.

1. BANORËT AFATGJATË QË NUK MUND TË MARRIN DOKUMENTACION TË LËSHUAR NGA KOSOVA

Kjo kategori përbëhet nga dy nën-grupe të veçanta individësh të cilët, pavarësisht lidhjeve afatgjata me Kosovën, mbeten të paafhtë të pajisen me dokumente të lëshuara nga institucionet e Kosovës.

Nën-grupi i parë përfshin individë që i përmbushin kriteret ligjore dhe kushtetuese për shtetësinë e Kosovës dhe për këtë arsye duhet t'i nënshtrohen vetëm procedurës së verifikimit të së drejtës për shtetësi. Megjithatë, në praktikë atyre shpesh u kërkohet të kalojnë përmes procesit dukshëm më të ndërlikuar dhe më të gjatë të natyralizimit.

Nën-grupi i dytë përbëhet nga individë që kanë jetuar në Kosovë për periudha të gjata kohore dhe janë thellësisht të integruar në jetën shoqërore, ekonomike dhe familjare lokale. Në terma praktikë, ata nuk janë të ardhur të rinj apo banorë të përkohshëm. Shumë prej tyre i plotësojnë kushtet substanciale që zakonisht lidhen me qëndrimin e ligjshëm për qëllime të natyralizimit, përfshirë strehimin e qëndrueshëm, punësimin, arsimin dhe lidhjet e vendosura familjare.

Pavarësisht dallimeve ndërmjet këtyre dy nën-grupeve, të dy përballen me pengesa të ngjashme strukturore në qasjen në dokumentet e lëshuara nga institucionet e Kosovës. Këto pengesa burojnë nga mosnjohja e dokumenteve të lëshuara nga Serbia, regjistrimet e pazgjidhura të gjendjes civile, sistemet administrative të fragmentuara dhe praktikat procedurale të paqëndrueshme. Në shumë raste, individëve u kërkohet të paraqesin dokumente shtesë që nuk janë të përcaktuara qartë me ligj, marrin udhëzime kontradiktore nga zyrtarë të ndryshëm ose u kërkohet të sigurojnë dokumente që në praktikë është pothuajse e pamundur të sigurohen.

Megjithatë, situata e nën-grupit të parë ngre shqetësime veçanërisht të rëndësishme juridike. Këta individë gëzojnë një të drejtë kushtetuese për shtetësi si pasardhës të shtetasve të ish Republikës Federale të Jugosllavisë që kishin vendbanim të përhershëm në Kosovë më 1 janar 1998. Në praktikë, qasja në këtë të drejtë kushtetuese është bërë e kushtëzuar në mënyrë të dyfishtë.

Së pari, një akt nënligjor — një udhëzim administrativ — e interpreton në mënyrë restriktive nocionin e “pasardhësve”, duke e kufizuar atë vetëm tek individët më të rinj se 18 vjeç. Ky interpretim në fakt vendos një kufi moshe, pas të cilit individët nuk mund të ndjekin më procedurën e verifikimit të së drejtës për shtetësi dhe në vend të kësaj duhet të aplikojnë përmes procesit më kompleks të natyralizimit.

Së dyti, pasi ridrejtohen drejt procedurës së natyralizimit, shumë aplikantë përballen me një pengesë shtesë: pasaportat e lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë shpesh nuk pranohen si dokumentacion i vlefshëm për regjistrimin e vendbanimit. Meqenëse regjistrimi i vendbanimit është parakusht për fillimin e procedurës së natyralizimit, individët mund të gjenden në një situatë ku nuk janë në gjendje ta nisin fare këtë proces.

Kjo pengesë dokumentare prek gjithashtu edhe nën-grupin e dytë — individët që nuk kanë të drejtë të trashëguar për shtetësinë e Kosovës përmes prindërve — megjithëse për ta çështja e pasaportës është vetëm një ndër disa sfida administrative që hasen gjatë procesit të natyralizimit.

Si rezultat i këtyre faktorëve të kombinuar, përfshirë praktikën që në mënyrë efektive e kushtëzojnë qasjen në të drejta të garantuara me Kushtetutë, përmbushja formale e kërkesave të Ligjit për të Huajt bëhet strukturalisht e paarrtshme për shumë banorë afatgjatë. Pavarësisht integritetit të tyre faktik dhe pranisë së zgjatur në Kosovë, këta individë mund të klasifikohen dhe trajtohen juridikisht si “të huaj”, duke krijuar një mospërputhje të thellë midis realitetit të jetuar dhe statusit juridik. Në mungesë të aranzhimeve kalimtare ose zgjidhjeve të përshtatura, qëndrimi afatgjatë nuk përkthehet në siguri juridike, duke kontribuar në pasiguri të vazhdueshme ligjore dhe cenueshmëri.

2. PUNONJËSIT DHE STUDENTËT E INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRUARA NGA SERBIA

Një grup i dytë i prekur në mënyrë joproporcionale përfshin profesionistët dhe studentët, punësimi ose arsimimi i të cilëve është i lidhur me institucionet e administruara nga Serbia, veçanërisht në fushat e shëndetësisë dhe arsimit. Ky grup përfshin mjekë, profesorë, mësimdhënës dhe studentë që mund të banojnë pjesërisht ose tërësisht jashtë Kosovës, ose lidhja institucionale e të cilëve nuk përputhet me kategoritë e banimit të njohura zyrtarisht.

Për këta persona, sfida kryesore qëndron në vërtetimin e “qëllimit të qëndrimit” të njohur ligjërisht sipas Ligjit për të Huajt. Kontratat e punës, certifikatat e regjistrimit dhe dokumentacioni institucional, të lëshuara nga institucionet e administruara nga Serbia, shpesh nuk njihen nga autoritetet e Kosovës, duke i vënë personat në një situatë ku angazhimi i tyre profesional ose arsimor nuk mund të përkthehet lehtësisht në një status juridik në përputhje me ligjin. Kjo pasiguri thellohet më tej nga fakti se autoritetet e Kosovës nuk e njohin statusin juridik të institucioneve të administruara nga Serbia, duke lënë të pazgjidhur nëse dokumentet e lëshuara nga këto institucione mund të pranohen si provë e vlefshme me qëllim të rregullimit të qëndrimit.

Kjo situatë e rrit rrezikun për shqiptimin e gjobave, humbjen e statusit të qëndrimit ose masave të largimit, edhe kur personat ushtrojnë funksione thelbësore për shoqërinë ose ndjekin studimet në mirëbesim. Studentët që jetojnë në konvikte përballen me pasiguri shtesë në lidhje me regjistrimin e adresës, ndërsa profesionistët e punësuar në shëndetësi dhe arsim mund të përballen me sanksione pavarësisht shërbimit shumëvjeçar për komunitetet lokale.

Në të dy rastet, mosrespektimi nuk buron nga shmangia ose mosgatishmëria për t’u bindur ligjit, por nga mospërputhjet strukturore ndërmjet realiteteve institucionale ekzistuese dhe kërkesave formale të kornizës ligjore.

3. PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDË VENDIT (PZHBV)/REFUGJATËT NGA KOSOVA

Një kategori tjetër që potencialisht preket nga zbatimi i Ligjit për të Huajt përbëhet nga personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) me prejardhje nga Kosova që nuk posedojnë dokumentacion të lëshuar nga Kosova. Edhe pse këta persona janë zhvendosur nga Kosova dhe në kontekste të ndryshme administrative dhe humanitare njihen si persona të zhvendosur, ata formalisht mund të bien brenda përkufizimit të “të huajve” sipas Ligjit për të Huajt, nëse nuk kanë shtetësinë e Kosovës.

Për shumë persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), mungesa e dokumentacionit rrjedh nga rrethanat që kanë të bëjnë me zhvendosjen, përfshirë humbjen e dokumenteve, çështjet e pazgjidhura të regjistrimit në gjendjen civile dhe qëndrimin e gjatë jashtë Kosovës. Në mungesë të mekanizmave të veçantë ligjorë ose masave mbrojtëse kalimtare, këtyre personave mund t’u kërkohej të rregullojnë qëndrimin e tyre si shtetas të huaj kur ndodhen në Kosovë, pavarësisht historikut të zhvendosjes së tyre dhe lidhjes së tyre të gjatë me territorin.

Kjo krijon një situatë juridike veçanërisht të ndjeshme, pasi personat e zhvendosur nga Kosova mund të trajtohen si të huaj në raport me vendin e tyre të origjinës. Mungesa e qartësisë lidhur me mënyrën se si statusi i personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) ndërvepron me kërkesat për qëndrim sipas Ligjit për të Huajt rrezikon të përkeqësojë cënueshmëritë ekzistuese dhe mund të ngre shqetësime lidhur me sigurinë juridike, proporcionalitetin dhe përputhshmërinë me mbrojtjet më të gjera që lidhen me zhvendosjen.

LIGJI PËR AUTOMJETET

Sipas Ligjit për Automjetet, automjetet që marrin pjesë në trafikun rrugor në Kosovë duhet të jenë të regjistruara dhe të përdoren në përputhje me ligjin, pavarësisht nga vendi i regjistrimit, pronësia ose shtetësia e drejtuesit të mjetit.

Pronarëve dhe drejtuesve të automjeteve, në përgjithësi, u kërkohet:

- të sigurohen që automjeti të jetë i regjistruar siç duhet dhe që dokumentet e regjistrimit të jenë të vlefshme dhe të njohura për përdorim në trafikun rrugor në Kosovë;
- të respektojnë standardet e përcaktuara teknike dhe të sigurisë, përfshirë inspektimet e detyrueshme teknike dhe kërkesat për sigurimin e automjeteve;
- të respektojnë dallimin ndërmjet automjeteve të regjistruara në Kosovë dhe atyre të regjistruara jashtë vendit, përfshirë edhe rregullën që automjetet me regjistrim të huaj, në përgjithësi, mund të marrin pjesë në trafikun rrugor në Kosovë deri në tre (3) muaj nga data e hyrjes, duke iu nënshtruar disa kushteve shtesë;
- të respektojnë afatet e ndryshme kohore të zbatueshme për përdorimin e automjeteve me regjistrim të huaj, të cilat mund të ndryshojnë në varësi të pronësisë, shtetësisë, vendbanimit ose statusit të qëndrimit dhe vendit të regjistrimit;
- të dëshmojnë pronësinë e ligjshme ose autorizimin e vlefshëm për të përdorur mjetin, veçanërisht kur drejtuesi nuk është pronari i regjistruar;
- të mbajnë me vete gjithmonë dokumentacionin e vlefshëm të mjetit, përfshirë dëshminë e regjistrimit, kontrollin teknik, sigurimin dhe, kur është e zbatueshme, autorizimin me shkrim për të drejtuar një mjet në pronësi të një personi tjetër;
- të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente gjatë kontrolleve të trafikut, inspektimeve dhe procedurave të zbatimit të ligjit, duke përfshirë verifikimin e respektimit të afateve kohore që janë në fuqi.

Sipas udhëzimeve publike të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, në praktikë zbatohen edhe dallime shtesë, duke përfshirë:

- periudha më të shkurtra të përdorimit të lejuar në disa raste (p.sh., deri në tetë (8) ditë kur drejtuesi nuk ka qëndrim të rregulluar në vendin ku është regjistruar automjeti);
- kufizime në përdorimin e automjeteve me targa të huaja me autorizim, përfshirë rastet kur kërkohet prania e pronarit të automjetit;
- rregulla të veçanta lidhur me përdorimin e patentë-shoferëve të huaj, të cilat mund të jenë të vlefshme deri në një (1) vit për kategori të caktuara të drejtuesve.

Megjithëse prezantohen formalisht si sqarime, këto dallime ndikojnë ndjeshëm në mënyrën se si ligji përjetohet dhe zbatohet në praktikë.

Mosrespektimi i këtyre detyrimeve mund të rezultojë në sanksione administrative, gjoba, kufizime në përdorimin e automjetit ose sekuestrim të automjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PROBLEMET KYÇE

Ashtu si në rastin e Ligjit për të Huajt, edhe zbatimi i Ligjit për Automjetet ndikohet në masë të madhe nga çështjet e pazgjidhura të dokumentacionit, të cilat e kushtëzojnë mundësinë e individëve për të demonstruar përdorimin e ligjshëm të automjetit, statusin e qëndrimit dhe autorizimin.

1. PRONARËT E AUTOMJETEVE TË REGJISTRUARA NË SERBI

Grupi i parë përbëhet nga persona që drejtojnë automjete të regjistruara në Serbi të cilat janë në pronësi të tyre personale. Për shumë prej këtyre personave, këto automjete përbëjnë mjetin kryesor, dhe shpesh të vetmin, të transportit, i cili është thelbësor për qasjen në punë, kujdes shëndetësor, arsim dhe shërbime të tjera bazike.

Ndonëse korniza ligjor lejon përdorimin e automjeteve të regjistruara jashtë vendit për një periudhë të kufizuar – zakonisht deri në tre muaj nga data e hyrjes – udhëzimet e dhëna nga autoritetet zbulojnë regjime të shumta kohore paralele, në varësi të statusit të qëndrimit, shtetësisë dhe kushteve të tjera. Ky kompleksitet e bën të vështirë për pronarët e automjeteve të përcaktojnë se cilat rregulla zbatohen për ta në praktikë.

Vazhdon të ketë paqartësi lidhur me mënyrën e llogaritjes së datës së hyrjes, trajtimin e hyrjeve të përsëritura dhe mënyrën se si përdorimi i ligjshëm i automjetit lidhet me statusin e qëndrimit ose të qëndrimit të përkohshëm të drejtuesit. Si rezultat, edhe personat që janë pronarë të ligjshëm të automjeteve të tyre mund të përballen me kufizime në përdorim, gjoba ose sekuestrim, jo për shkak të ndonjë shkeljeje, por si rezultat i mbivendosjes së rregullave dhe interpretimeve jokonsistente të tyre.

2. DREJTUESIT E AUTOMJETEVE TË REGJISTRUARA NË SERBI NË BAZË TË AUTORIZIMIT

Grupi i dytë përfshin personat që përdorin automjete të regjistruara në Serbi në bazë të autorizimit, jo si një zgjidhje të përkohshme apo ndihmëse, por si mënyrë kryesore dhe afatgjatë për të siguruar lëvizjen e përditshme. Këta persona shpesh janë me banim të përhershëm në Kosovë dhe mbështeten në përdorimin e automjeteve me autorizim pikërisht për shkak se statusi i tyre i banimit ua pamundëson të regjistrojnë një automjet në emrin e tyre me targa të lëshuara nga Serbia. Kjo formë e përdorimit të automjeteve nuk është rastësore, por pasqyron një përshtatje të përhapur ndaj kufizimeve që lidhen me qëndrimin dhe regjistrimin, për shkak të të cilave personave që janë banorë të përhershëm në Kosovë u pamundësohet në mënyrë strukturore të regjistrojnë në emrin e tyre automjete me targa të lëshuara nga Serbia.

Në praktikë, automjetet shpesh regjistrohen në emrin e një personi tjetër – zakonisht të dikujt me vendbanim të regjistruar në Serbi – që është i autorizuar ligjërisht të bëjë regjistrimin e automjetit. Megjithatë, drejtues i autorizuar është përdoruesi kryesor i automjetit dhe varet nga ai për aktivitetet e përditshme, përfshirë udhëtimin për në punë, qasjen në kujdes shëndetësor, arsim dhe shërbime thelbësore.

Sipas kornizës rregullative aktuale, përdorimi i automjeteve të regjistruara jashtë vendit në bazë të autorizimit i nënshtrohet një regjimi veçanërisht kufizues dhe të kushtëzuar. Kërkesat që lidhen me prezencën e pronarit të automjetit, të jetë banor në vendin e regjistrimit të automjetit, ose autorizimin e lëshuar jashtë vendit, nuk e pasqyrojnë këtë realitet, duke e trajtuar përdorimin me autorizim si të përkohshëm ose të jashtëzakonshëm, në vend se ta konsiderojnë si strukturalisht të nevojshëm.

Si rezultat, personat që në praktikë janë drejtuesit kryesorë të automjeteve të tyre mund të posedojnë autorizim të vlefshëm, sigurim dhe patentë shoferi, por megjithatë nuk janë në gjendje të përmbushin kërkesat formale që lidhen me vendbanimin ose prezencën e pronarit. Kjo e shndërron një rregullim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm në një burim të vazhdueshëm të pasigurisë juridike.

Drejtuesit që vozisin me autorizim po ashtu janë të ekspozuar në mënyrë joproporcionale gjatë kontrolleve rrugore, ku statusi zyrtar i autorizimit kontestohet më lehtë. Dallimi midis praktikës faktike dhe supozimeve rregullatore e rrit rrezikun e ndëshkimeve të menjëhershme dhe forcon perceptimet e paparashikueshmërisë dhe zbatimit selektiv.

3. PËRDORIMI I AUTOMJETEVE TË INSTITUCIONEVE DHE IMPLIKIMET NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Sfidat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Automjetet nuk ndikojnë vetëm te personat privatë. Ato përfshijnë edhe përdorimin e automjeteve zyrtare nga institucionet që veprojnë në Kosovë, disa prej të cilave vazhdojnë të mbështeten në automjete të regjistruara në Serbi.

Si rezultat, kufizimet dhe afatet kohore që lidhen me përdorimin e automjeteve kanë pasoja jo vetëm për lëvizjet e personave, por edhe për kapacitetin operativ të shërbimeve institucionale, veçanërisht në sektorë si arsimit dhe shëndetësia, ku funksionimi i përditshëm varet nga përdorimi i rregullt i automjeteve zyrtare.

EFEKTET MË TË GJERA DHE KUMULATIVE

Përtej dispozitave të tyre të drejtpërdrejta ligjore, zbatimi i Ligjit për të Huajt dhe i Ligjit për Automjetet duhet të kuptohet brenda një konteksti më të gjerë dhe kumulativ të ndryshimeve të vazhdueshme institucionale dhe rregullative. Kjo përfshin përpjekjet e shpallura dhe ato që janë duke vazhduar për integrimin e institucioneve të arsimit dhe shëndetësisë që janë nën administrimin e Serbisë, ndryshimet në qeverisjen administrative, si dhe mungesën e vazhdueshme të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe (AKS/BKMS), si një mekanizëm i strukturuar për adresimin e nevojave specifike të komunitetit.

Këto zhvillime po ndodhin kryesisht jashtë kornizave të vendosura të dialogut dhe pa mekanizma mbrojtës apo kalimtarë ishin të paraparë për të shoqëruar transformime të tilla sektoriale. Në këtë kontekst, zbatimi i masave rregullative nuk mund të shihet i izoluar nga mjedisi më i gjerë institucional në të cilin ato funksionojnë.

Pasiguria juridike lind jo vetëm nga përmbajtja e vetë ligjeve, por edhe nga mënyra dhe koha e zbatimit të tyre. Komunikimi publik ka theksuar afatet e zbatimit dhe sanksionet – veçanërisht në lidhje me fillimin e paralajmëruar të zbatimit të plotë – pa ofruar qartësi përkatëse lidhur me procedurat, garancitë apo mekanizmat kalimtarë realistë. Kjo ka kontribuar në rritjen e pasigurisë tek personat e prekur.

Ndikimi kumulativ i këtyre masave shkon përtej çështjeve të pajtueshmërisë formale ligjore. Kërkesat që lidhen me vendbanimin dhe kufizimet në përdorimin e automjeteve ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e lëvizjes, statusin juridik dhe funksionimin e përditshëm të studentëve, punonjësve shëndetësorë, profesorëve dhe profesionistëve të tjerë, angazhimi i të cilëve është thelbësor për funksionimin e sistemeve të arsimit dhe shëndetësisë. Në sektorët që janë duke kaluar nëpër transformime të ndjeshme dhe të ngarkuara politikisht, pasiguria rregullative rrezikon në mënyrë të tërthortë të kufizojë ofrimin e shërbimeve dhe të ndikojë në vazhdimësinë dhe cilësinë e tyre.

Kur masa të shumta ligjore dhe administrative zbatohen paralelisht – pa koordinim, dialog apo mbështetje të mjaftueshme institucionale – efekti i tyre i kombinuar mund të jetë thellimi i ndjenjës së cenueshmërisë juridike. Kjo është veçanërisht e dukshme në fusha që janë thelbësore për jetën e përditshme, përfshirë qasjen në arsim, shëndetësi, punësim dhe liri të lëvizjes.

Në këtë kontekst, ekziston rreziku që pajtueshmëria rregullative të trajtohet si zëvendësim për integrimin funksional. Përputhshmëria formale me kërkesat administrative nuk i zgjidh, në vetvete, çështjet institucionale dhe të qeverisjes që janë të nevojshme për integrimin e qëndrueshëm dhe legjitim të shërbimeve. Pa marrëveshje të negociuara dhe të mbështetura në mënyrë institucionale – si ato që fillimisht ishin paraparë përmes AKS/BKMS – masat rregullative mund të perceptohen si instrumente të njëanshme të ristrukturimit, e jo si pjesë e një procesi koherent dhe konsensual të integritit.

Në kushte të tilla, efekti kumulativ i këtyre zhvillimeve paralele rrezikon të minojë qartësinë juridike, të dobësojë besimin në institucione dhe të intensifikojë brishtësinë shoqërore, në vend se të konsolidojë stabilitetin.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Gjetjet e kombinuara nga diskutimi në Forumin e Pulsit të Komunitetit dhe analiza më e gjerë kontekstuale çojnë në një përfundim të qëndrueshëm: shqetësimet kryesore të identifikuara nuk burojnë nga formulimi formal i vetë ligjeve, por nga mjedisi politik, administrativ dhe institucional në të cilin po bëhet zbatimi i tyre.

Kur zbatohen paralelisht me masat e shpallura për integrimin në arsim dhe shëndetësi – dhe në mungesë të vazhdueshme të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe (AKS/BKMS) – këto ligje rrezikojnë të veprojnë jo thjeshtë si instrumente teknike rregullative, por si mekanizma që në mënyrë të tërthortë riformësojnë realitetet institucionale pa i zgjidhur çështjet themelore strukturore. Kjo dinamikë ngre shqetësime jo vetëm për pasigurinë juridike dhe ndikimin e pabarabartë, por edhe për qëndrueshmërinë, legjitimitetin dhe realizueshmërinë afatgjatë të proceseve të integrimit që zhvillohen në kushte të tilla.

Zbutja e këtyre rreziqeve kërkon më shumë sesa vetëm pajtueshmëri formale me standardet rregullatore evropiane. Kjo kërkon komunikim të qartë dhe të qasshëm, aranzhime kalimtare realiste dhe gjithëpërfshirëse, akomodim ose njohje të dokumentacionit ekzistues, si dhe zbatim të qëndrueshëm dhe jodiskriminues. Në mënyrë thelbësore, reformat sektoriale dhe përpjekjet për integrim duhet të jenë të integruara në korniza të dakorduara dhe të mbështetura në mënyrë institucionale – veçanërisht në ato që fillimisht ishin paraparë për të adresuar çështjet specifike të komuniteteve dhe qeverisjes sektoriale, përfshirë edhe përmes AKS/BKMS.

Në mungesë të masave të tilla, efekti kumulativ i këtyre zhvillimeve paralele rrezikon të dëmtojë edhe më tej besimin në institucione, të kufizojë funksionimin e shërbimeve publike thelbësore dhe të thellojë ndarjet ekzistuese shoqërore, në vend se të konsolidojë qartësinë juridike dhe stabilitetin institucional.

